



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Administrimit të Zgjedhjeve

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

“PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KZAZ NR. 11, BASHKIA KUKËS, PËR ZGJEDHJET
E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”

Referuar nenit 19, shkronja “ç”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 7, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, miratuar me vendimin e Komisionit Rregullator, nr. 5, datë 20.11.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëron anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve.

Bazuar në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 722, datë 19.8.2023, “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 11, për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”, “Partia Socialiste e Shqipërisë”, “Partia e Lirisë” dhe “Partia Demokratike” depozituan kandidaturat për anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 11.

Të dhënat e kandidaturave të paraqitura, u verifikuan për plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 29 pika 1, gërma “c” dhe “ç”, nenin 30 dhe nenin 31, të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim të veprimeve procedurale për verifikim e të dhënave të kandidaturave dhe të verifikimit në DPB (Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve), rezulton se kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 30, dhe 31, të Kodit Zgjedhor, si dhe nuk figurojnë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Erion META

Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Majlinda ÇELMETA

Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ

Sekretar i Përgjithshëm





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: .8.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

“EMËRIMIN E ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KZAZ NR. 11, BASHKIA KUKËS, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 7 të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

- Emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 11, propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, “Partia e Lirisë”, dhe “Partia Demokratike”, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 3 vjet

K.Nogu _____

E.Meta _____

M.Çelmeta _____

Y.Merkaj _____

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: .8.2023 Nr:
Ora:



“Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 11, Bashkia Kukës, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”

Qarku	Bashkia	KZAZ	Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti	Pozicioni
Kukës	Kukës	11	1	Defrim	Remzi	Korbi	PS	Anëtar
			2	Sahit	Sadik	Doçi	PS	Anëtar
			3	Besar	Ramazan	Tota	PS	Anëtar
			4	Tigri	Agim	Braha	PS	Anëtar
			5	Shkelqim	Bajram	Shehu	PL	Anëtar
			6	Petrit	Imer	Lleshaj	PL	Anëtar
			7	Igli	Ardian	Elezi	PL	Sekretar
			8	Ilmi	Shani	Duraku	PD	Anëtar